



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA- REPUBLIC OF KOSOVO	
Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit Regulatorni Autoritet za Usluge Vode Water Services Regulatory Authority	
Nr. prot./Prot. Br./ Prot. No.	490
Mjesht./Medinon/Unit	D
Nr. shkronj./Ipts. Br./Req. No.	23.09.2016
Datë/Datum/Date PRISTINË - PRIŠTINA - PRISTINA	

**RREGULLORE Nr.07/2016
PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË UJIT NË
KOSOVË**

Shtator 2016

PËRMBAJTJA

KREU I: DISPOZITAT E PËRGJITHSHME	2
Neni 1: Qëllimi.....	2
Neni 2: Fushëveprimi	2
Neni 3: Përkufizimet.....	2
Neni 4: Rregullat e Interpretimit.....	5
Neni 5: Aplikueshmëria	5
KREU II: POLITIKAT DHE PARIMET E PËRGJITHSHME PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE	6
Neni 6: Politikat Tarifore	6
Neni 7: Parimet/kushtet për përcaktim të tarifave	7
Neni 8 Procedurat për përcaktimin e tarifave	8
Neni 9: Kërkesat për Informacion	8
Neni 10: Aplikacioni për Tarifa Shërbimi.....	9
Neni 11: Shqyrtimi i Aplikacionit.....	9
Neni 12 Shqyrtimi i akteve interne të ofruesve të shërbimeve.....	10
Neni 13: Shqyrtimi i Tarifave.....	11
Neni 14: Procesi Tarifor.....	11
Neni 15: Aprovimi i Tarifave të Shërbimit.....	12
Neni 16: Korrigjimet e rregullta të Tarifave të Shërbimit	12
Neni 17: Korrigjime të Jashtëzakonshme të Tarifave të Shërbimit.....	12
Neni 18: Procedurat e Aprovimit për Korrigjimet e Jashtëzakonshme	13
të Tarifave të Shërbimit.....	13
Neni 19: Refuzimi i Korrigjimit të Jashtëzakonshëm të Tarifave të Shërbimit.....	13
KREU III: MARRËVESHJET PËR TARIFA E SHËRBIMIT	13
Neni 20: Marrëveshja për Tarifat e Shërbimit	13
Neni 21: Negocimi për Marrëveshjen e Tarifave të Shërbimit	14
Neni 22: Lidhja e Marrëveshjes për Tarifat e Shërbimit	15
Neni 23: Natyra Ligjore dhe Zbatueshmëria e Marrëveshjes së Tarifave të Shërbimit.....	15
Neni 24: Pajtueshmëria me Marrëveshjen për Tarifat e Shërbimit.....	16
KREU IV: PUBLIKIMI I TARIFAVE TË SHËRBIMIT	16
Neni 25: Prezantimi i Tarifave të Shërbimit	16
Neni 26: Publikimi dhe Shpërndarja e Listës së Tarifave të Shërbimit	16
Neni 27: Zbatimi i Kushteve të Tarifave të Shërbimit	17
Neni 28: Raportet dhe mbajtja e shënimeve	17
Neni 29: Dispozitat ndëshkimore dhe administrative	17
Neni 30: Ankesat	18
Neni 31: Gjuha Zyrtare	18
Neni 32: Dispozitat shfuqizuese.....	18
Neni 33: Hyrja në Fuqi.....	Error! Bookmark not defined.

Në mbështetje të Nenit 4 nënparagrafi 3.6, Nenit 19 paragrafi 3 dhe Nenit 47 të Ligjit Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 4/2016, e datës 14 Janar 2016) Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit nxjerr:

RREGULLORE Nr. 07/2016 PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË UJIT NË KOSOVË

KREU I: DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1: Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregullore është që të krijojë rregulla dhe procedura mbi të cilat mund të përcaktohen, shqyrtohen dhe zbatohen tarifat për shërbimet e furnizimit me ujë, grumbullimin, trajtimin dhe shkarkimin e ujërave të ndotura, dhe furnizimin e ujit me shumicë.

Neni 2: Fushëveprimi

Të gjithë Ofruesit e Shërbimeve të Ujit që aktualisht ofrojnë Shërbime të Ujësjellësit, Ujërave të Ndotura dhe Shërbime të Furnizimit të Ujit me Shumicë në Kosovë do të zbatojnë këtë Rregullore dhe procedurat për zhvillim, marrjen e aprovimit, shqyrtimin dhe ndryshimin e tarifave për shërbimet e ofruara.

Neni 3: Përkufizimet

1. Fjalët dhe shprehjet e përdorura në këtë Rregullore do kenë kuptimet si në vijim:
 - 1.1. **Autoriteti** - Autoriteti rregullator për shërbimet e ujit (ARRU) si autoritet i pavarur, përgjegjës për rregullimin e veprimtarive të ofruesve të shërbimit në Kosovë;
 - 1.2. **Aplikacioni për Tarifat e Shërbimit** - dokumenti i dorëzuar Autoritetit nga Ofruesit e Shërbimeve, në formatin e përcaktuar nga Autoriteti kohë pas kohe;
 - 1.3. **Ditë Pune** - çdo ditë përveç të shtunës dhe të dielës, apo ditë tjetër që është festë zyrtare në Kosovë;
 - 1.4. **Faturë** - dokumenti komercial për të paguar shërbimet e ofruara, e cila saktëson, së paku, shumën e borxhit për pagesë, dhe periudhën për të cilën janë ofruar shërbimet, të lëshuar nga ofruesi i shërbimeve për konsumatorët, në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës;

- 1.5. **Furnizues i Ujit me Shumicë** – çdo ofrues i shërbimit që ka licencë të shërbimit për furnizim të ujit me shumicë të përpunuar ose të papërpunuar;
- 1.6. **Furnizimi dhe Shitja e Ujit me Shumicë** – personi ose subjekti ligjor i cili blen Ujin me Shumicë nga Ofruesi i Shërbimeve për qëllime të ri-shitjes së tij te pala e tretë;
- 1.7. **Kategoria e konsumatorëve** - kategoria e konsumatorëve të definuar si në vijim:
 - 1.7.1. **Konsumator shtëpiak** – konsumatori i klasifikuar nga Ofruesi i shërbimeve si konsumator i cili shfrytëzon shërbimet në banesën e tij apo saj për nevoja të amvisërisë;
 - 1.7.2. **Konsumator komercial/industrial** - personi, subjekti ligjor ose organizata afariste e klasifikuar nga Ofruesi i shërbimeve si konsumator i cili shfrytëzon shërbimet për apo në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së vet industriale apo komerciale të cilit do lloj;
 - 1.7.3. **Konsumator institucional** - subjekti ligjor i klasifikuar nga Ofruesi i shërbimeve si autoritet qeveritar, autoritet lokal, organizatë ndërkombëtare apo institucion i cili kryen veprimtaritë të interesit të përbashkët apo publik dhe i cili nuk është i regjistruar si organizatë afariste në pajtim me Ligjin për shoqëritë tregtare Nr. 02/L-123;
- 1.8. **Kërkesa e të Hyrave** - shuma e parave të nevojshme për mbulimin e kostove për ofrimin e Shërbimeve të Ujës-jellësit dhe Ujërave të Ndotura ose Furnizimit të Ujit me Shumicë të llogaritura në pajtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje;
- 1.9. **Komisioni Shqyrtues** - komisioni që mund të rishikojë vendimet e Autoritetit në pajtim me Ligjin Nr. 05/L-042;
- 1.10. **Konsumator** - personi i cili ka lidhur kontratë për shërbime me ofruesin e shërbimeve ose merr shërbime nga ofruesi i shërbimeve;
- 1.11. **Kontrata e Shërbimit** - kontrata standarde e cila lidhet në mes të Ofruesit të shërbimeve dhe konsumatorit e cila rregullon ofrimin e shërbimeve, të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese;
- 1.12. **Kostot Operative** - kostot racionale dhe të nevojshme që lidhen me funksionimin dhe mirëmbajtjen e impianteve të trajtimit të ujit dhe ujërave të ndotura, rezervuarve, puseve, pompave, linjave transmetuese dhe atyre shpërndarëse, objekteve tjera të ujës-jellësit dhe ujërave të ndotura, dhe shpenzimet për shërbimet e konsumatorëve si dhe ato të administratës së përgjithshme;
- 1.13. **Kthimi në Kapital** – kthimi i bazuar dhe i arsyeshëm në vlerën e investimeve të bëra nga ofruesi i shërbimeve ose pronari/ët e tij;
- 1.14. **Lista e Tarifave të Shërbimit** - të gjitha Tarifat e zbatueshme të Shërbimit për

Zonën e Shërbimit sipas llojit të shërbimit, lokacionit dhe kategorisë së Konsumatorëve dhe tarifave për Shërbimet e Ujësjetësimit dhe Ujërave të Ndotura që janë aprovuar nga Autoriteti;

- 1.15. **Ofruesi i Shërbimeve** - çdo ofrues i shërbimeve të ujësjetësimit, ujërave të ndotura dhe furnizuesit të ujit me shumicë;
- 1.16. **Personi** - person fizik apo juridik i cili mund të jetë publik apo privat;
- 1.17. **Politika Tarifore** - politika e autoritetit rregullator e cila vendos parimet mbi të cilat përcaktohen tarifave të shërbimit;
- 1.18. **Shërbimet e Ujit** – shërbimet e ujësjetësimit, ujërave të ndotura dhe furnizimi i ujit me shumicë;
- 1.19. **Shërbimet e Kanalizimit** - shërbime në infrastrukturën fizike të cilat shërbejnë për të përcjellur ujërat e ndotura;
- 1.20. **Shërbimet e ujërave të ndotura** – grumbullimi, bartja, trajtimi dhe shkarkimi i ujërave të ndotura të përdorura nga shfrytëzuesi shtëpiak, komercial, industrial dhe publik;
- 1.21. **Shërbimet e Ujësjetësimit** – marrja, përpunimi dhe shpërndarja e ujit për konsum njerëzor si dhe operimi i rrjetit dhe objekteve për atë qëllim;
- 1.22. **Shërbimet e ujit me shumicë të pa përpunuar** – shërbim për ujin e mbledhur, ose të ekstraktuar i cili si i pa përpunuar furnizohet si ujë me shumicë;
- 1.23. **Shërbimet e ujit me shumicë të përpunuar** – shërbim i ujit të mbledhur, ose të ekstraktuar i cili si i përpunuar furnizohet si ujë me shumicë;
- 1.24. **Shpenzimet Kapitale** - shpenzimet që shkaktohen lidhur me investimet në asetet fikse me jetëgjatësi më shumë se një vit duke përfshirë pa kufizim edhe shpenzimet e llogaritura të amortizimit dhe zhvlerësimit gjatë jetëgjatësisë së cilitdo aset fiks të dhënë, të klasifikuar si pronë, stabiliment ose pajisje;
- 1.25. **Struktura e Tarifore** - elementet specifike të tarifave të shërbimit përfshirë bllok -tarifave, komponentët fikse të tarifave, taksat e lidhjes dhe hollësitë tjera lidhur me aplikimin e tarifave të shërbimit që janë aprovuar nga Autoriteti;
- 1.26. **Taksa për lidhjen e autorizuar** - taksat e Ofruesit të Shërbimeve për sigurimin e lidhjeve të reja (ose ri-lidhjeve) në shërbimet e furnizimit me ujë ose shërbimet e ujërave të ndotura siç janë të aprovuara nga Autoriteti;
- 1.27. **Tarifa e Shërbimit** - vlera, ngarkesa apo tarifa fikse të Ofruesit të Shërbimeve me

të cilat Ofruesi i Shërbimit e ngarkon konsumatorin në lidhje me ofrimin e shërbimeve;

1.28. **Uji me Shumicë** – uji i përpunuar ose i papërpunuar i cili furnizohet si ujë me shumicë;

1.29. **Urdhëresa Tarifore e Shërbimit** - dokumenti me shkrim, i lëshuar nga Autoriteti ku janë të përfshira të gjitha Tarifat e Shërbimit për Zonat e Shërbimit sipas llojit, lokacionit dhe kategorisë së Konsumatorëve;

1.30. **Zona e Shërbimit** - rajoni ose komunat në të cilat ofruesi relevant i shërbimeve duhet të ofrojë shërbimet e tij në bazë të licencës së shërbimit;

1.31. **Zhvlerësimi** - masën e harxhimit (konsumit), shfrytëzimit ose amortizimit të aseteve gjatë periudhës së jetëgjatësisë së tyre ekonomike;

Neni 4: Rregullat e Interpretimit

Në këtë Rregullore:

1. Çdo fjalë apo shprehje e përdorur, të cilat nuk janë veçanërisht të definuara këtu dhe të cilat mund të jenë të paqarta, do të përmbajnë kuptimin siç janë përcaktuar në aktet ligjore ose në çfarëdo ligji tjetër të aplikueshëm në Kosovë;
2. Referencat do të interpretohen sipas kuptimit të çdo Rregulloreje të lëshuar, ndryshuar, plotësuar, dhe/apo zëvendësuar nga Autoriteti kohë pas kohe në pajtim me kompetencat që i janë dhënë Autoritetit;
3. Fjalët që përdoren në çfarëdo gjinie do të përfshijnë edhe gjininë tjetër;

Neni 5: Aplikueshmëria

Gjithë Ofruesit e shërbimit që aktualisht apo planifikojnë të ofrojnë Shërbime të Ujës-jellësit ujërave të ndotura dhe/ose të Furnizimit të Ujit me Shumicë kërkohet të respektojnë/aplikojnë këtë Rregullore përveç nëse nuk bëhet ndonjë përjashtim i veçantë dhe i dhënë me shkrim nga Autoriteti.

KREU II: POLITIKAT DHE PARIMET E PËRGJITHSHME PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE

Neni 6: Politikat Tarifore

1. Tarifat e Shërbimit për furnizim të ujit dhe shërbimet e ujërave të ndotura dhe të furnizimit të ujit me shumicë nuk duhet të jenë diskriminuese dhe, përveç nëse ndryshe vendoset nga Autoriteti, Ofruesit e Shërbimeve duhet të përdorin Tarifat e njëjta të Shërbimit në Zonat e tyre të Shërbimit.
2. Autoriteti mund të përcaktojë tarifa zonale, nëse e konsideron të arsyeshme, për raste specifike me një vendim brenda regjionit të caktuar të shërbimit, për ato grupime të konsumatorëve që u ofrohen shërbime të ujit dhe shërbime të trajtimit të ujërave të ndotura, ose furnizimit të ujit me shumicë të trajtuar ose të pa trajtuar pa i ndikuar tarifat ekzistuese të pjesës tjetër të regjionit përkatës.
3. Tarifat për shërbimet e furnizimit të ujit me shumicë duhet të përcaktohen në bazë të kostove aktuale të furnizimit tek secili Ofrues i Shërbimeve të Ujësjellësit dhe ujërave të ndotura.
4. Tarifat duhet të përcaktohen në bazë të asaj që rrjedhja e të hyrave që ato i gjenerojnë, të jenë të mjaftueshme për të financuar aktivitetet e Ofruesve të Shërbimeve në përputhshmëri me kërkesat e tyre ligjore dhe Rregullatore, që përkufizohet: si kërkesë e të hyrave e cila hyn në raport me sasinë e ujit të shitur dhe arkëtimin, e që mund të ndryshohet me politikat e veçanta tarifore.
5. Ofruesi i Shërbimeve mund të kërkojë nga Autoriteti përdorim të tarifave të ndryshme të shërbimit brenda zonave të caktuara të shërbimeve të tij, duke arsyetuar kërkesën e tillë dhe Autoriteti duhet të përgjigjet me shkrim brenda njëzet (20) ditëve të punës nga data e pranimit të kërkesës së tillë, duke pranuar ose refuzuar ta bëjë këtë si dhe të sigurojë arsyet për qëndrimin e tij.
6. Tarifat për shërbimet e ujësjellësit dhe ujërave të ndotura duhet të përfshijnë jo më shumë se tri kategori të Konsumatorëve:
 - 6.1 konsumator Shtëpiak;
 - 6.2 konsumator Komercial/Industrial;
 - 6.3 konsumator Institucional;
7. Konsumator i ujit me shumicë do të jetë e vetmja kategori e konsumatorëve që furnizohet me ujë me shumicë.
8. Objektet e kultit lirohen nga pagesa për shërbimet e ujit sipas Ligjit Nr. 05/L-042., në këtë lirim nuk përfshihen objektet tjera përcjellëse administrative dhe fitimprurëse.
9. Në bazë të Ligjit për Zjarrfikje dhe Shpëtim Nr.04/L-049, Njësia për Zjarrfikje dhe

Shpëtim në rastet e intervenimeve kur shfrytëzon ujin nga burimet e ujit, pa marr parasysh se kujt i takon/përket e shfrytëzon pa ndonjë kompensim.

Neni 7: Parimet/kushtet për përcaktim të tarifave

1. Autoriteti duhet të përpilojë politikat tarifore për Shërbimet e Ujësjetës dhe ujërave të ndotura dhe Furnizim të Ujit me Shumicë duke marrë parasysh:
 - 1.1. Të gjitha obligimet ligjore që kanë të bëjnë me përcaktimin e tarifave të shërbimit
 - 1.2. Përgjegjësinë sociale dhe rolin e ofruesve të shërbimeve:
 - 1.2.1. Uniformiteti i tarifave në zonat e shërbimit;
 - 1.2.2. Kategori të ndryshme të konsumatorëve, qasja kufizuese e tyre dhe kostot përkatëse të tyre;
 - 1.2.3. Strukturat e tarifave përfshirë në rast nevojë edhe bllok tarifat dhe tarifat fikse;
 - 1.2.4. Nivelet e shërbimit;
 - 1.3. Taksat e lidhjeve/ri-lidhjeve dhe përshtatshmërinë e kontributeve ndaj investimeve kapitale;
 - 1.4. Mjedisin:
 - 1.4.1. Përshtatshmërinë e strukturës tarifore për menaxhimin e kërkesës dhe taksat për marrjen e ujit të papërpunuar dhe shkarkimin e ujërave të ndotura;
 - 1.4.2. Caqet për reduktimin e humbjeve të ujit;
 - 1.4.3. Detyrimi mjedisor për kujdesin dhe pajtueshmërinë me standardet e mjedisit;
 - 1.5. Mbulimin e kostos:
 - 1.5.1. Përkufizimi;
 - 1.5.2. Kostot operative dhe pritjet e efikasitetit;
 - 1.5.3. Mbulimi i shpenzimeve të investimeve kapitale;
 - 1.6. Financimin, strukturën e kapitalit dhe kthimin në kapital;
 - 1.7. Procesin e shqyrtimit të tarifave;
 - 1.8. Çfarëdo qëndrimi tjetër të politikës tarifore siç përcaktohet nga Autoriteti.
2. Politikat tarifore do të përpilohen përmes procesit të konsultimit me palët e interesit.
3. Autoriteti do të publikojë Politikat Tarifore që do të jenë në dispozicion për publikun.
4. Autoriteti duhet të rishikojë Politikat Tarifore në mënyrë periodike dhe kur është nevoja ato do të ndryshohen në rast të:
 - 4.1. Ndryshimeve në politikën qeveritare;
 - 4.2. Amendamenti në legjislacionin ekzistues ose kur kërkohen ndryshimet e politikave Tarifore me legjislacion;
 - 4.3. Amendamenteve në këtë rregullore, ose
 - 4.4. Në rast të dështimit të Politikave ekzistuese tarifore për të dhënë rezultate të pritura ose duke identifikuar qasje tjera alternative të cilat mund të japin rezultate më të mira.

Neni 8 Procedurat për përcaktimin e tarifave

1. Autoriteti duhet të përgatis, për secilin Shqyrtim periodik të Tarifave, një pako të Procedurave për Tarifat e shërbimit me Ujë (Procedurat për Rishikimin Tarifor dhe Udhëzimet e Kontabiliteti Rregullator), që:
 - 1.1. Ofrojnë koncepte të përgjithshme të procesit për përcaktimin e tarifave për periudhën e ardhshme të shqyrtimit;
 - 1.2. Përshkruajnë modelin financiar që do të përdoret në proces;
 - 1.3. Përshkruajnë në detaje komponentët individuale të modelit për përcaktimin e tarifave duke përfshirë:
 - 1.3.1. Parashikimet e shitjeve të llogaritura;
 - 1.3.2. Kostot operative;
 - 1.3.3. Kostot e mirëmbajtjes kapitale;
 - 1.3.4. Kthimin në kapital (përfshirë definimin e bazës rregullatore të aseteve);
 - 1.3.5. Financimet e jashtme;
 - 1.3.6. Procesin e llogaritjes së tarifave;
 - 1.3.7. Procesin e përshtatjes ('smoothing') kur është nevoja;
 - 1.3.8. Rregullat e indeksimit për korigjimet e ndërmjetme;
 - 1.3.8.1. efikasiteti i ofruesit të shërbimeve;
 - 1.3.8.2. shpenzimet e ofrimit të lidhjes;
 - 1.3.8.3. mjaftueshmëria e tarifës për shërbime;
 - 1.3.8.4. përgjegjësia e institucioneve qeveritare;
 - 1.3.8.5. nevoja e parashikimit të një tarife bazë për shërbime, etj;
 - 1.3.9. Hollësitë tjera siç përcaktohen nga Autoriteti.
2. Autoriteti do të përgatis procedura për rishikime periodike të tarifave të shërbimeve të ujit për rastet kur rishqyrton tarifat për mos arritje të caqeve të përcaktuar me procesin e rregullt 3 ose/apo 5 vjeçar tarifor dhe posaçërisht për mos realizim të projekteve të investimeve kapitale të aprovuara nga Autoriteti dhe Ofruesi i Shërbimeve me të cilat ngritët baza rregullatore e aseteve, duke marr parasysh edhe përgatitjen e procedurave për aplikim të lëvizjeve inflatore në vend.
3. Tarifat duhet të përcaktohen në pajtim me Procedurat e finalizuara.

Neni 9: Kërkesat për Informacion

1. Autoriteti do të përcaktojë Kërkesat për Informacion të nevojshme për përcaktim të tarifave në pajtim me Procedurat.
2. Ofruesi i Shërbimeve do të sigurojë informacione të nevojshme në pajtim me kërkesat për Informacion dhe brenda afatit të përcaktuar nga Autoriteti.
3. Këto kërkesa për Informacion kanë të bëjnë me:

- 3.1. Parashikimet e performancës (prodhimi, shitjet, lidhjet, tarifat fikse etj.)
 - 3.2. Parashikimet e kostove operative;
 - 3.3. Shpenzimet kapitale përfshirë mirëmbajtjen kapitale;
 - 3.4. Amortizimin sipas udhëzimeve të Autoritetit (BRR);
 - 3.5. Detajet e financimit;
 - 3.6. Informacionet tjera të përcaktuara nga Autoriteti si të nevojshme për përcaktimin e tarifave.
4. Autoriteti nuk është i obliguar t'i marrë parasysh informacionet e dhëna nga Ofruesit e Shërbimeve dhe nëse Autoriteti konsideron që parashikimet e performancës, kostot, investimet dhe burimet e financimit nuk janë reale atëherë Autoriteti i mund:
 - 4.1. T'i kthej të dhënat Ofruesit të Shërbimeve për rishqyrtim dhe korigjim; ose/apo
 - 4.2. Të përdor të dhëna alternative të cilat sipas mendimit të Autoritetit më mirë reflektojnë performancën e pritur të ardhshme të Ofruesit e Shërbimeve.

Neni 10: Aplikacioni për Tarifa Shërbimi

1. Ofruesi i Shërbimeve do të dorëzojë Aplikacionin për Tarifa të Shërbimit në pajtim me Procedurat së bashku me të gjitha informacionet mbështetëse siç është përcaktuar në kërkesat për Informacion.
2. Ofruesi i Shërbimeve do të sigurojë informacione shtesë për të mbështetur Aplikacionin e Tarifave të Shërbimit siç kërkohet nga Autoriteti.
3. Aplikacioni i Tarifave të Shërbimit do të aprovohet nga Bordi i Drejtorëve i Ofruesve të Shërbimeve që dëshmohet me letrën përcjellëse të nënshkruar nga autoriteti relevant.
4. Autoriteti mban të drejtën për të përcaktuar tarifat në pajtim me Procedurat dhe informacionet e siguruara në pajtim me kërkesat për Informacione edhe në rast se Ofruesi i Shërbimeve nuk e dorëzon Aplikacionin formal të Tarifave.
5. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i dorëzon informacionet e nevojshme mbështetëse në pajtim me kërkesat për Informacion dhe në afat të përcaktuar në Procedura, Autoriteti do të përcaktojë Tarifat e Shërbimit bazuar në supozimet e Autoritetit për kërkesën e të hyrave, nivelin e pritshëm të efijencës së Ofruesit të Shërbimeve dhe performancës së tij operative. Në raste të tilla, Tarifat e Shërbimit do të jenë jo më të larta, në kuptimin real (pas përshtatjes për inflacion) se tarifa e aplikuar në fund të periudhës së mëparshme periodike të shqyrtimit.

Neni 11: Shqyrtimi i Aplikacionit

1. Autoriteti do të konfirmojë që Aplikacioni i Tarifave të Shërbimit është në përputhshmëri me kushtet e kësaj Rregullore, Procedurat dhe Kërkesat për Informacion. Autoriteti do të shqyrtojë hollësisht dhe të vlerësojë Aplikacionin për Tarifa Shërbimi,

qoftë për ta aprovuar, ose refuzuar aplikacionin.

2. Autoriteti mund të përdor qasje shkencore të arsyeshme për t'i sfiduar të dhënat e Ofrueseve të Shërbimit për të pasur performancë më të mirë, në: humbjet e ujit, shpenzimet operative, arkëtim, investime kapitale, etj.
3. Të dhënat e sfiduara nga Autoriteti duhet të përdoren nga Ofruesit e Shërbimeve kur ata përpilojnë planet e tyre të biznesit për palët tjera të interesit.
4. Autoriteti duhet të vlerësojë Aplikacionin për Tarifat e Shërbimit në bazë të:
 - 4.1. Përputhshmërisë së tij me procedurat, kërkesat për Informacion dhe kërkesat tjera rregullatore;
 - 4.2. Parashikimeve të performancës teknike dhe financiare në të cilat është bazuar Aplikacioni për Tarifa Shërbimi të cilat do të përmbushin pritjet e Autoritetit të përmbushjes së caqeve reale dhe për të përcaktuar arritshmërinë e performancës;
 - 4.3. Kostove operative të cilat do të reflektojnë përmirësimet sfiduese por reale të efijencës siç është përcaktuar nga Autoriteti;
 - 4.4. Parashikimeve të shpenzimeve për investimeve kapitale të cilat do të jenë reale dhe mund të arsyetohen, për përmbushjen e standardeve të shërbimit ose niveleve tjera të shërbimit;
5. Gjatë vlerësimit të Aplikacionit për Tarifa Shërbimi, Autoriteti do të marrë parasysh performancën ekonomike dhe financiare të Ofruesit të Shërbimeve duke krahasuar atë me performancën e krahasueshme e të pritur ose aktuale të Ofruesve tjerë të Shërbimeve duke pasur me këtë rast parasysh faktorët jo tipik përfshirë pengesat topografike, ekonominë e shkallës dhe të ngjashme.

Neni 12 Shqyrtimi i akteve interne të ofruesve të shërbimeve

1. Autoriteti shqyrton dhe miraton aktet interne të punës së ofruesve të shërbimit nga aspekti rregullativ për t'u siguruar se janë në përputhje me legjislacionin dhe kërkesat rregullatore.
2. Aktet që duhet të hartohen nga ofruesit e shërbimeve dhe të aprovohen nga Autoriteti, përfshijnë:
 - 2.1. Planet e biznesit;
 - 2.2. Planet e menaxhimit të aseteve;
 - 2.3. Planet afatgjata të investimeve;
 - 2.4. Planet e menaxhimit të thatësisë;
 - 2.5. Planet e furnizimit me ujë në situata të emergjencave;

Neni 13: Shqyrtimi i Tarifave

1. Tarifat për shërbimet e ujësjellësit, ujërave të ndotura dhe shërbimeve të furnizimit të ujit me shumicë do të përcaktohen për një periudhë jo më pak se tri vite dhe jo më shumë se pesë vite.
2. Autortieti ka të drejtë për rishikim – korigjimit të tarifave të përcaktuara të vitit pasues gjatë periudhës së ekzistimit të tarifave tri (3)/ose pesë (5) vjeçare, për mos përmbushje të caqeve të përcaktuar me procesin rregullator, posaçërisht në rastet kur dështohet në realizmin e projekteve të investimeve kapitale të aprovuara me burim vetanak financimi e të cilat janë kalkuluar si kosto për tarifë.
 - 2.1. Inicimi i rishikimeve të tilla tarife bëhet nga Autoriteti, pas analizës 9 mujore/ose pas përmbylljes së vitit fiskal ekzistues, për të përcaktuar tarifat e vitit pasues, në rastet kur Autoriteti sigurohet se nuk mund të arrihen/ose ofrohen për t'u arrit caqet e përcaktuara me procesin rregullator. Këto veprime do të ndërmerren pas një analize dhe vlerësimi të gjithanshëm të performancës së çdo ofruesi të shërbimit veç e veç duke marr parasysh edhe rrethanat e mjedisit biznesor.
 - 2.2. Urdhëresa e Tarifave të Shërbimit (UTSH) për rastin e pikës 9.2. do të lëshohen para përmbylljes së vitit të shikuar, ose ma së voni nga 25 gjerë më 31 janar të vitit në të cilin hymë.
3. Tarifat për furnizim të ujit me shumicë do të përcaktohen për periudhat e ngjashme si për shërbimet e ujësjellësit dhe ujëra të ndotura.
4. Tarifat për secilin vit brenda periudhës së shqyrtimit duhet të përcaktohen paraprakisht në bazë të kostove reale duke përjashtuar efektet e inflacionit.
5. Tarifat aktuale që do të aplikohen do të jenë të përcaktuara gjatë shqyrtimit shumëvjeçar të të dhënave të tyre, të konsideruara: arritje/ose mos arritje të caqeve të përcaktuar me procesin tarifor të vitit të shikuar dhe të përshtatura/korigjuara për lëvizjet e përgjithshme inflatore të çmimeve me pakicë të ndodhura në vitin para procesit të korigjimit.

Neni 14: Procesi Tarifor

1. Para fillimit të vitit përfundimtar të secilës periudhë të shqyrtimit, Autoriteti do të përcaktojë orarin e aktiviteteve të nevojshme për të ndërmarrë shqyrtimin e tarifave për periudhën vijuese. Këto aktivitete do të përfshijnë (por jo të kufizohen në):
 - 1.1. Qasjen e Autoritetit për përcaktimin e tarifave (draft Procedurat) në shqyrtimin e ardhshëm si dokument konsultues;

- 1.2. Mundësinë për përfshirjen e palëve të interesit (Ofruesit e Shërbimeve, konsumatorët dhe palët tjera të interesit) dhe publikimin e Procedurave finale;
- 1.3. Kërkesat e hollësishme për informacione të cilat janë të nevojshme për përmbushjen e kërkesave të përcaktuara me procedura;
- 1.4. Draftin e tarifave të bazuar në procedura e përcaktuara;
- 1.5. Mundësinë e përfshirjes së komenteve nga palët e interesit në draftin e tarifave të përcaktuara;
- 1.6. Publikimin e tarifave finale të përcaktuara që do të aplikohen në periudhën shqyrtuese;

Neni 15: Aprovimi i Tarifave të Shërbimit

Në bazë të kriterëve të vlerësimit të përcaktuar në këtë Nen, Autoriteti do të aprovojë me apo pa modifikime Aplikacionin për Tarifat e Shërbimit me shkrim pas lëshimit të Urdhëresës për Tarifa.

Neni 16: Korrigjimet e rregullta të Tarifave të Shërbimit

1. Tarifat e Aprovuara të Shërbimit do të aplikohen për Periudhën e Shqyrtimit të Tarifave, të cilat sipas procedurave i nënshtrohen korrigjimeve vjetore në pajtim me rezultatet e shqyrtimit të gjithanshëm të tarifave, për arritje/ose mos arritje të caqeve të përcaktuara për realizim me procesin tariforë të periudhës e posaçërisht atyre të investimeve kapitale të periudhës së shikuar dhe për lëvizjet inflatore siç është përcaktuar.
2. Në të kundërtën, gjatë periudhës ndërmjet dy shqyrtimeve të proceseve tarifore, Tarifat e Shërbimit duhet të mbesin të pandryshuar për secilin vit.

Neni 17: Korrigjime të Jashtëzakonshme të Tarifave të Shërbimit

1. Ofruesi i Shërbimeve mund të dorëzojë aplikacionin për Korrigjime të Jashtëzakonshëm të Tarifave të Shërbimit në pajtim me procedurat.
2. Aty ku procedurat nuk specifikojnë kushtet e Korrigjimeve të Jashtëzakonshme të Tarifave të Shërbimit mund të aplikohen ose procedurat nuk parashikojnë rrethanat që nuk kanë qenë të mundshme për t'u parashikuar në përgatitjen e Aplikacionit të Tarifave të Shërbimit, Ofruesi i Shërbimeve mund të dorëzojë, në çfarëdo kohe, Autoritetit kërkesën me shkrim me të gjitha informatat e nevojshme mbështetëse për korrigjim të jashtëzakonshme të Tarifave të Shërbimeve më të larta ose më të ulëta se sa ato të aprovuara ose përcaktuara nga Autoriteti.
3. Korrigjimet e Jashtëzakonshme të Tarifave të Shërbimit, kur është nevojë do të bëhen vetëm në fillim të secilit vit brenda periudhës së shqyrtimit të tarifave përveç nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i shpreh Autoritetit nevojën për korrigjimin e Tarifës së

Shërbimit brenda vitit.

Neni 18: Procedurat e Aprovimit për Korrigjimet e Jashtëzakonshme të Tarifave të Shërbimit

1. Autoriteti do të konfirmojë që kërkesa për Korrigjime të Jashtëzakonshme të Tarifave të Shërbimit është në përputhje me Rregulloren mbi Tarifat e Shërbimit të vlerësojë dhe të përgjigjet brenda dyzet e pesë (45) ditëve të punës nga data e pranimit të aplikacionit të tillë nga Autoriteti.
2. Autoriteti do të vlerësojë Kërkesën për Korrigjim të Jashtëzakonshëm të Tarifave të Shërbimit në pajtim me procedurat ose në pajtim me rrethanat e përshkruara në aplikacion që janë të mjaftueshme të sigurojnë Korrigjimin e Jashtëzakonshëm të Tarifave të Shërbimit.
3. Nëse Autoriteti është i kënaqur me kërkesën për Korrigjim të Jashtëzakonshëm të Tarifave të Shërbimit e cila përmbush kërkesat për korrigjim, Autoriteti do të aprovojë me shkrim kërkesën pas lëshimit të Urdhëresës së Tarifave të Shërbimit.

Neni 19: Refuzimi i Korrigjimit të Jashtëzakonshëm të Tarifave të Shërbimit

1. Autoriteti mund të refuzojë të aprovojë kërkesën për korrigjim të Jashtëzakonshëm të Tarifave të Shërbimit, bazuar në:
 - 1.1. dështimin e Aplikuesit të sigurojë informacionet e kërkuara brenda afatit të caktuar;
 - 1.2. vlerësimin se kërkesa e Aplikuesit nuk është financiarisht e arsyeshme;
 - 1.3. vlerësimin se Aplikuesi nuk ka përmbush standardet minimale të shërbimit,
 - 1.4. dështimin e Aplikuesit të kontrollojë kostot operative ose humbjet e ujit ose që të dyjat.

KREU III: MARRËVESHJET PËR TARIFA E SHËRBIMIT

Neni 20: Marrëveshja për Tarifat e Shërbimit

1. Autoriteti mund të lidh marrëveshje me shkrim me cilindo Ofrues të Shërbimeve me qëllim ndryshimi, zëvendësimi ose plotësimi të Tarifave të Shërbimit të përcaktuara sipas kësaj Rregulloreje.
2. Marrëveshjet për Tarifat e Shërbimit mund të lidhen duke dhënë paraprakisht ndonjë kusht të përcaktuar nga Autoriteti i cili i propozohet Ofruesit të Shërbimeve duke përfshirë, pa kufizime, lidhjen e marrëveshjeve tjera me Ofruesin e Shërbimeve mbi:
 - 2.1. Nxjerrjen, përtëritjen, zgjerimin, ndryshimin, dhe plotësimin e Standardëve të Shërbimit;

- 2.2. Lëshimin, përtëritjen, vazhdimin, ndryshimin, dhe plotësimin e Licencës së Shërbimit;
 - 2.3. Zgjerimin apo zvogëlimin e fushëveprimit territorial të Zonës së Shërbimit;
 - 2.4. Zgjerimin, rehabilitimin ose riparimin e Rrjeteve të Ujësjetës;
 - 2.5. Krijimin, zëvendësimin, zgjerimin, modifikimin dhe/ose plotësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me konsumatorë, siç është përcaktuar në Rregulloren mbi Kartën e Konsumatorëve të lëshuar, ndryshuar, modifikuar dhe/ose plotësuar nga Autoriteti kohë pas kohe.
3. Për mënjanimin e dyshimit, Ofruesit e Shërbimeve kanë të drejtë por jo obligim t'i propozojnë Autoritetit të lidhin Marrëveshjen për Tarifat e Shërbimit, në pajtim me dispozitat e Nenit 20.

Neni 21: Negocimi për Marrëveshjen e Tarifave të Shërbimit

1. Ofruesit e Shërbimeve të cilët dëshirojnë të lidhin Marrëveshje për Tarifat e Shërbimit duhet të parashirojnë kërkesë me shkrim Autoritetit, duke kërkuar hapjen e negociatave për të lidhur marrëveshjen e tillë dhe arsyetuar pse ata konsiderojnë se interesat publike, e drejta e tyre ligjore dhe pritjet e tyre ligjore do të përmbushen më mirë nëse Autoriteti pranon të lidh Marrëveshje për Tarifat e Shërbimit.
2. Autoriteti do të përgjigjet me shkrim brenda pesë (5) Ditëve të Punës nga data e pranimit të kërkesës së tillë, duke u pajtuar me hyrjen në negociatë për lidhjen e Marrëveshjes për Tarifa të Shërbimit ose duke e refuzuar atë.
3. Nëse Autoriteti refuzon të fillojë negociatat për lidhjen e Marrëveshjes për Tarifat e Shërbimit, ai do të tregojë arsyet e refuzimit të tillë.
4. Nëse Autoriteti pranon të fillojë negociatë për të lidh Marrëveshje për Tarifat e Shërbimit, ai do t'i ofrojë Ofruesit të Shërbimeve një periudhë të arsyeshme kohore në cilindo rast, por jo më pak se tridhjetë (30) Ditë të Punës për të mundësuar Ofruesit të Shërbimeve të dorëzojë Autoritetit propozimin e Marrëveshjes për Tarifat e Shërbimit.
5. Brenda dhjetë (10) Ditëve të Punës të pranimit të draft Marrëveshjes për Tarifat e Shërbimit, Autoriteti do të njoftoj me shkrim Ofruesin e Shërbimeve për caktimin e takimit të parë për të negociuar për atë marrëveshje.
6. Autoriteti mund të përcaktojë periudhën maksimale kohore për konkludimin e negociatave për të lidhur Marrëveshjen për Tarifat e Shërbimit, e cila nuk mund të jetë më pak se njëzet (20) Ditë të Punës nga data e caktimit të takimit të parë të negociatave si në nenin 21.5.
7. Për mënjanimin e dyshimit, Autoriteti ka të drejtë por jo edhe obligim të lidhë Marrëveshje për Tarifa të Shërbimit, prandaj as refuzimi i tij për të hyrë në negociatë për të lidh atë marrëveshje ose çfarëdo dështimi për të kompletuar me sukses negociatat

konsiderohen si vendime kontraktuese dhe jo si akte administrative apo vendimet që i nënshtrohen ndonjë shqyrtimi administrativ ose gjyqësor.

Neni 22: Lidhja e Marrëveshjes për Tarifat e Shërbimit

1. Në rast të konkludimit të suksesshëm nga negociatat e bëra në pajtim me Nenin 20 të kësaj rregullore, Autoriteti dhe Ofruesi i Shërbimeve duhet të lidhin me shkrim Marrëveshjen për Tarifat e Shërbimit.
2. Marrëveshja për Tarifat e Shërbimit duhet të nënshkruhen në tri versione të gjuhëve që përdoren në Kosovë:
 - 2.1. Gjuhën shqipe;
 - 2.2. Gjuhën serbe; ose edhe në
 - 2.3. Gjuhën angleze.
3. Në rast të mospërputhshmërisë së versioneve në të cilat nënshkruhet Marrëveshja për Tarifat e Shërbimit, versioni në Gjuhën Shqipe do të mbizotërojë.
4. Përveç nëse ndonjë fakt, informacion ose dokument mund të konsiderohen se përmbajnë ndonjë informacion të privilegjuar ose konfidencial, që Autoriteti mund të arsyetojë me vendim me shkrim, Marrëveshja për Tarifat e Shërbimit, Shtojcat e saj dhe të gjitha informacionet e përdorura për negociata dhe lidhjen e marrëveshjes së tillë do të jetë në dispozicion për publikun me anë të mjeteve të cilat Autoriteti mund t'i përcaktojë kohë pas kohe.
5. Çdo ndryshim, zëvendësim, modifikim ose plotësim i dispozitave që lidhen me Marrëveshjen për Tarifat e Shërbimit do të kërkojë pëlqimin nga Autoriteti dhe Ofruesi i Shërbimeve që ka nënshkruar atë dhe do të bëhet me shkrim dhe të publikohet sipas dispozitave të nenit 22.4.

Neni 23: Natyra Ligjore dhe Zbatueshmëria e Marrëveshjes së Tarifave të Shërbimit

1. Marrëveshja për Tarifa të Shërbimit konsiderohet si kontratë për të gjitha qëllimet e synuara ligjore ku Autoriteti është i obliguar të negociojë, lidh dhe zbatojë marrëveshjen e tillë me një observim strikt të parimeve të përgjithshme ligjore, rregullave dhe procedurave që drejtojnë detyrën e të drejtave dhe funksioneve të autoritetit publik.
2. Marrëveshja për Tarifat e Shërbimit, si akt bilateral ligjor lidhet në mënyrë të ligjshme, zbatohet dhe ekzekutohet në pajtim me kushtet e të dyja palëve dhe mund të ndryshohet, zgjerohet, modifikohet, plotësohet, shqyrtohet ose ndërprehet vetëm në pajtim me dispozitat e saja dhe ligjin e zbatueshëm në Kosovë.

Neni 24: Pajtueshmëria me Marrëveshjen për Tarifat e Shërbimit

1. Ofruesit e Shërbimeve janë të obliguar të respektojnë dhe të jenë në përputhshmëri me Tarifat e Shërbimit të përcaktuara me kushtet e përgjithshme të kësaj Rregulloreje:
 - 1.1. Përderisa negociatat për lidhjen e Marrëveshjes së Tarifave të Shërbimit janë në pritje, deri në datën e hyrjes në fuqi të marrëveshjes së tillë;
 - 1.2. Menjëherë me përfundimin, anulimin, revokimin ose skadimin e Marrëveshjes së Tarifave të Shërbimit përveç nëse nuk është arritur ndonjë marrëveshje që të mbetet në fuqi, çfarëdo të drejte dhe obligimi të cilat i përmban Marrëveshja për Tarifat e Shërbimit shfuqizohen për çfarëdo shkaku ligjore;
 - 1.3. Në të gjitha aspektet kur Marrëveshja për Tarifat e Shërbimit nuk ka përcaktuar ndryshe ose në të gjitha aspektet të cilat nuk i ka paraparë në mënyrë specifike ajo marrëveshje;

KREU IV: PUBLIKIMI I TARIFAVE TË SHËRBIMIT

Neni 25: Prezantimi i Tarifave të Shërbimit

Ofruesi i shërbimeve do të përmbledh Tarifat e Shërbimit ashtu siç janë aprovuar, korigjuar ose rishikuar nga Autoriteti në Listën e Tarifave të Shërbimit që do të përgatitet siç është përcaktuar nga Autoriteti kohë pas kohe.

Neni 26: Publikimi dhe Shpërndarja e Listës së Tarifave të Shërbimit

1. Ofruesi i Shërbimeve do t'ia shpërndajë secilit Konsumator Listën e Tarifave të Shërbimit siç është aprovuar nga Autoriteti, në kohën kur Konsumatori ka lidh Kontratë Shërbimi ose njëherë në vit t'i bashkëngjis të njëjtën Faturës.
2. Tarifat e Shërbimit siç janë aprovuar nga Autoriteti do të publikohen nga Ofruesi i Shërbimeve:
 - 2.1. në gazetatat me qarkullim të gjerë në Zonën e Shërbimit ku do të aplikohen Tarifat e tilla të Shërbimit; dhe
 - 2.2. publikimet e tilla do të përsëriten së paku njëherë në javën pasuese të javës kur është bërë publikimi i parë;
3. Ofruesi i Shërbimeve do të jetë vet përgjegjës për publikimin dhe informimin publik të Tarifave të Shërbimit.

KREU V: ZBATIMI, MASAT NDËSHKIMORE DHE ANKESAT

Neni 27: Zbatimi i Kushteve të Tarifave të Shërbimit

1. Autoriteti do të monitorojë përputhshmërinë dhe shkallën e përmbushjes së objektivave të përcaktuara me tarifa të shërbimit sipas kësaj Rregulloreje në bazë të:
 - 1.1. Raporteve të dërguara nga Ofruesit e Shërbimeve, në pajtim me formatin e përcaktuar nga Autoriteti kohë pas kohe;
 - 1.2. Inspektimeve, dhe
 - 1.3. Shqyrtimeve të raporteve të dërguara nga entitetet tjera dhe autoritetet publike.

Neni 28: Raportet dhe mbajtja e shënimeve

1. Secili Ofrues i Shërbimeve do të përgatis dhe dorëzojë Autoritetit raportet në formën e përcaktuar dhe brenda intervaleve të përcaktuara nga Autoriteti, kohë pas kohe.
2. Secili Ofrues i Shërbimeve do t'i dorëzojë Autoritetit raportet e të dhënave të performancës mujore dhe vjetore;
 - 2.1. raportet mujore të muajit përkatës i dërgohen Autoritetit deri më datën 20 të muajit pasues;
 - 2.2. raportet vjetore të vitit përkatës i dërgohen Autoritetit deri më datën 31 Mars të vitit pasues;
3. Raportime tjera sipas kërkesave të Autoritetit për shqyrtime dhe analiza eventuale që ndërlidhen me proceset rregullatore.
4. Në bazë të raporteve të dorëzuara nga Ofruesit e Shërbimeve në ARRU, Autoriteti përpilon raporte periodike dhe vjetore me të cilat analizon dhe vlerëson përmbushjen e objektivave të përcaktuara me procesin rregullator të tarifave.
5. Të gjithë regjistrat/shënimet duhet të mbahen në zyrën kryesore të Ofruesit të Shërbimeve në mjedisin e sigurt dhe të besueshëm së paku 5 (pesë) vite kalendarik nga dita kur ato janë përgatitur së pari herë apo në ndonjë afat tjetër të përcaktuar me ndonjë ligj tjetër dhe të jenë në dispozicion gjatë orëve të rregullta të punës për shqyrtim/inspektim nga Autoriteti.

Neni 29: Dispozitat ndëshkimore dhe administrative

1. Ofruesit e shërbimeve të cilët dështojnë të jenë në përputhje me këtë rregullore do të gjobiten sipas ligjit në fuqi.
2. Gjobat për shkeljen e kësaj Rregulloreje do të llogariten dhe do të vihen në pajtim me Rregulloren mbi vënien e gjobave e nxjerrur nga Autoriteti.

Neni 30: Ankesat

1. Ofruesit e Shërbimeve mund të parashtrojnë ankesën tek Komisioni Shqyrtues, i themeluar në pajtim me Ligjin nr.05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit të datës 30 Janar 2016, për:
 - 1.1. lëshimin, kufizimin, modifikimin, ndryshimin, plotësimin, përtëritjen ose zgjerimin e Tarifave të Shërbimit;
 - 1.2. revokimin, deklarimin e ndërprerjes ose anulimin e cilësdo Tarifë të Shërbimit të përcaktuar nga Autoriteti sipas kësaj Rregullore;
 - 1.3. përcaktimin ose zbatimin e cilitdo prej Kushteve të Tarifave të Shërbimit të parapara me këtë Rregullore;
 - 1.4. vënien e çfarëdo gjobe për çfarëdo shkelje të Kushteve të Tarifave të Shërbimit ose për shkeljen e cilësdo dispozitë të kësaj Rregulloreje.
2. Me marrjen e çfarëdo vendimi konkret mbi zbatueshmërinë e kësaj Rregulloreje, Autoriteti do të informojë Ofruesin e Shërbimeve të cilit i'u është adresuar vendimi i tillë i zbatueshmërisë, mbi të drejtat e tij për t'u ankuar në pajtim me këtë Nen.
3. Ofruesit e Shërbimeve mund të ankohen në gjykatën me juridiksion kompetent për çfarëdo vendimi të marrë nga Komisioni Shqyrtues mbi cilat do vendime konkrete sipas zbatueshmërisë së kësaj Rregulloreje në pajtim me Ligjin Nr.05/L-042.

PJESA VI: TË NDRYSHME

Neni 31: Gjuha Zyrtare

1. Kjo Rregullore miratohet dhe publikohet në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.
2. Në rast të ndonjë mospërputhjeve në mes të versioneve në të cilat kjo rregullore është nxjerr, versioni në gjuhën shqipe do të mbizotërojë.

Neni 32: Dispozitat shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për përcaktim të tarifave të shërbimit për shërbimet e ujësjellësit, ujërave të ndotura dhe të furnizimit të ujit me shumicë në Kosovë (R-02/U&K) e datës 24 dhjetor 2012.

Neni 33: Hyrja në Fuqi

Kjo Rregullore do të hyjë në fuqi shatë (7) ditë pas nënshkrimit nga Drejtori i Autoritetit.



Raif Preteni
Drejtor i ARRU

